

Titulli i lëndës: PROJEKTIM - KOMPLEKSET E PARKIMIT STACIONAR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	PROJEKTIM - KOMPLEKSET E PARKIMIT STACIONAR
Niveli:	baçelor
Statusi i lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II / semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Arta Xhambazi
Të dhënat kontaktuese:	arta.xhambazi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton analizën arkitektonike dhe funksionale të objekteve të parkimit stacionar dhe rolin e tyre në strukturën urbane dhe në sistemet e mobilitetit të qytetit. Kursi shqyrton tipologjitë kryesore të garazheve, organizimin e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve, si dhe parimet teknike që përcaktojnë dimensionimin dhe organizimin e hapësirave të parkimit. Përmes analizës së projekteve ekzistuese dhe ushtrimeve analitike studentët zhvillojnë aftësinë për të interpretuar kërkesat funksionale dhe teknike të objekteve garazhuese. Lënda përfshin analiza tipologjike dhe ushtrime skematike që ndihmojnë në kuptimin e marrëdhënies ndërmjet arkitekturës, trafikut urban dhe mobilitetit. Studentët realizojnë punime analitike dhe prezantime që demonstrojnë kuptimin e parimeve arkitektonike dhe funksionale të objekteve të parkimit.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none">• Zhvillon aftësinë për të analizuar tipologjitë e objekteve të parkimit stacionar në raport me strukturën urbane dhe sistemet e mobilitetit.• Fuqizon kompetencën për të interpretuar organizimin funksional dhe parametrat teknikë të garazheve dhe sistemeve të parkimit.• Zhvillon aftësinë për të vlerësuar dhe krahasuar zgjidhje tipologjike të objekteve të parkimit në kontekst urban.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në përfundim të kursit studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none">– Identifikojë dhe kategorizojë tipologjitë kryesore të objekteve të parkimit stacionar në raport me strukturën urbane dhe funksionin e tyre.– Analizojë organizimin funksional dhe hapësinor të sistemeve të parkimit, duke përfshirë garazhet me rampa dhe sistemet mekanike të parkimit.– Interpretojë parimet arkitektonike dhe teknike që përcaktojnë dimensionimin dhe organizimin e objekteve

	<p>të parkimit.</p> <p>– Aplikojë parametrat bazë të projektimit për dimensionimin e rampave dhe organizimin e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve.</p> <p>– Vlerësojë ndikimin e objekteve të parkimit në organizimin e trafikut dhe në mobilitetin urban.</p> <p>– Krahasojë dhe argumentojë zgjidhje tipologjike të parkimit përmes analizës së projekteve ekzistuese.</p>
--	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	2	1
Puna në terren	3	2	6
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	2.5	15	37.5
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	0.5	2	1
Total			101.5

Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata tematike dhe konceptuale mbi tipologjitë e objekteve të parkimit dhe parimet arkitektonike e teknike të organizimit të tyre • Analizë e projekteve referuese për të interpretuar organizimin funksional dhe hapësinor të garazheve me rampa dhe sistemeve mekanike të parkimit. • Ushtrime analitike dhe llogaritëse për dimensionimin e rampave dhe parametrave bazë të qarkullimit në objekte të parkimit • Diskutime të strukturuar në klasë mbi ndikimin e objekteve të parkimit në organizimin e trafikut dhe mobilitetin urban. • Ushtrime diagramatike dhe skematike për analizën e organizimit funksional të objekteve garazhuese. • Prezantime të shkurtra të analizave nga studentët dhe diskutime kritike mbi zgjidhjet tipologjike të parkimit.
Metodat e vlerësimit:	<p>Punim seminarik – analizë e një objekti parkimi (50%)</p> <p>Studentët realizojnë një analizë tipologjike dhe funksionale të një objekti ekzistues të parkimit, duke përdorur diagrame dhe skema analitike për të interpretuar organizimin hapësinor dhe qarkullimin.</p>

	<p>Kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> • qartësia e analizës tipologjike • interpretimi i organizimit funksional • përdorimi i diagrameve dhe skemave analitike • argumentimi i ndikimit urban <p>Detyra dhe ushtrime gjatë semestrit (20%) Ushtrime analitike që lidhen me dimensionimin e rampave dhe organizimin e qarkullimit në objekte të parkimit.</p> <p>Ssaktësia e llogaritjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdorimi korrekt i parametrave të projektimit • qartësia e paraqitjes grafike • kuptimi i parimeve teknike <p>Provim me shkrim/kollokfiumi (30%) Vlerësim përfundimtar i njohurive teorike dhe analitike mbi tipologjitë e parkimit dhe parimet arkitektonike e teknike të organizimit të tyre.</p> <p>Kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> • saktësia konceptuale • përdorimi korrekt i terminologjisë arkitektonike • aftësia analitike dhe • qartësia e argumentimit. 	
<p>Literatura primare:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pech, A. et al. (2009). <i>Parkhäuser – Garagen: Grundlagen, Planung, Betrieb</i>. Birkhäuser. 2. Urban Land Institute (2010). <i>Dimensions of Parking (5th ed.)</i>. Urban Land Institute. 3. Henley, S. (2009). <i>The Architecture of Parking</i>. Thames & Hudson. 4. International Parking Institute (2018). <i>A Guide to Parking</i>. Routledge. 5. Willson, R. (2015). <i>Parking Management for Smart Growth</i>. Island Press. 	
<p>Literatura shtesë:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Chrest, A. et al. (2001). <i>Parking Structures: Planning, Design, Construction, Maintenance and Repair</i>. Springer. 2. Neufert, E., & Neufert, P. (2012). <i>Architects' Data</i>. Wiley-Blackwell. 	
<p>Hartimi i planit mësimor</p>		
<p>Java</p>	<p>Titulli i ligjëratis</p>	<p>Ushtrime</p>
<p>Java 1:</p>	<p>Hyrje në projektimin e objekteve të parkimit</p>	<p>Zgjedhja e zonës lokale dhe udhëzime për analizë</p>

Java 2:	Organizimi dhe problemet e parkimit në strukturën urbane	Analiza e parkimit në zonë (qarkullimi, kapaciteti)
Java 3:	Normat dhe dimensionimi i parkimit	Diagramet dhe skemat e parkimit lokal
Java 4:	Tipologjitë e objekteve të parkimit dhe sistemet e qarkullimit	Prezantimi i analizës së zonës lokale
Java 5:	Garazhet me rampa (të drejta të gjata dhe shkurta)	Zgjedhja e precedentit ndërkombëtar
Java 6:	Garazha me rampa spirale me etazha të rrafshta	Analiza e organizimit të precedentit
Java 7:	Garazha me etazha të pjerrëta	Diagramet funksionale dhe rampat e precedentit
Java 8	Diskutim i parimeve të projektimit të parkimit	Prezantimi intermediar i precedentit
Java 9:	Precedentë ndërkombëtarë të objekteve të parkimit	Analiza grafike
Java 10:	Këmbësori në objektet garazhuese	Zhvillimi i analizës
Java 11:	Konsultime tematike	Zhvillimi i analizës
Java 12:	Diskutim kritik	Zhvillimi i analizës
Java 13:	Parimet e projektimit të parkimit (sintezë)	Prezantim progresiv i punës
Java 14:	Konsultime përfundimtare	Përgatitja e prezantimit
Java 15:	Rikapitulimi i kursit	Dorëzimi i detyrës semestrale

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Të gjithë anëtarët e kursit pritet të sillen me profesionalizëm dhe respekt të ndërsjellë, pa asnjë formë diskriminimi apo ngacmimi.

Pajisjet digjitale lejohen vetëm për qëllime akademike, ndërsa plagjiatura, kopjimi dhe çdo formë mosndershmërie akademike nuk lejohen — të gjitha burimet duhet të citohen sipas standardit [APA/MLA] dhe çdo përdorim i AI duhet deklaruar; dorëzimi i materialeve të gjeneruara plotësisht nga AI pa kontribut personal konsiderohet shkelje akademike.

Detyrat dorëzohen brenda afatit të caktuar.

Marrja e kredive kushtëzohet me vijim të rregullt në ligjërata dhe ushtrime (Prania është e detyrueshme dhe më shumë se 3 mungesa në ligjërata dhe ushtrime nuk lejohen), me zhvillimin e plotë dhe vlerësimin pozitiv të detyrave semestrale, si dhe me kalimin e verifikimit teorik (kollokfiumi ose provimi).

Mosplotësimi i prerekuiziteve rezulton në çregjistrim nga lënda.